

Tabelë themelore në kater

(1) Pas zanores fillestare

për shkronjën e dytë: b d l-m n p r s-t u-y

përdor numrin: 2 3 4 5 6 7 8 9

(2) Pas shkronjës S

për shkronjën e dytë: a ch e h-i m-p t u ë-z

përdor numrin: 2 3 4 5 6 7 8 9

(3) Pas shkronjave Qu

për shkronjën e dytë: a e i o r t y

përdor numrin 3 4 5 6 7 8 9

(4) Pas shkronjave të tjera bashkëtingëllore

për shkronjën e dytë: a e i o r u y

përdor numrin: 3 4 5 6 7 8 9

(5) Për zgjerim

për shkronjën: a-d e-h i-l m-o p-s t-v w-z

përdor numrin: 3 4 5 6 7 8 9

Aplikimi i tabelës së katerit në mbiemër të autorit.

Forma më e zakonshme e aplikimit të tabelës së katerit është në mbiemrin e autorit. Tabela e katerit, duke iu shtuar KUD-it, mundëson radhitjen e materialit sipas mbiemrit të autorit si dhe mund të rezervojë hapësirë të mjaftueshme për radhitje për materialet e ardhshme të po atij autori. KUD-i së bashku me kater mund të zgjerohet po ashtu edhe me vit të botimit, duke ofruar edhe një nivel radhitje të materialeve nëpër raftë. Në raste të zbatueshme mund të shtohet edhe numri i vëllimit, etj. Nëse KUD-i është numër i gjatë, atë mund ta ndani në dy rreshta të kuptimtë.

Shembulli 1

Për autorin <Ramosaj, Berim> dhe veprën me titull "Management: (menaxhmenti kreativ me lidhshëm)", botuar më 2006, mund të bëjmë këtë radhitje të paraqitur në tiketën e mëposhtme, duke kombinuar elementet e mësipërme.

658 (075.8)
R366
2006

658(075.8) paraqet KUD-in, apo klasifikimin i cili i është caktuar veprës

R366 paraqet katër shkronjat e para të autorit, d.m.th. <RAMO>

"R" paraqet shkronjën e parë të mbiemrit të autorit "R" = <Ramosaj>

Numri i parë 3 paraqet shkronjën e dytë të mbiemrit të autorit "A" të shifruar nga tabela e katerit më lart. Shih vlerën numerike të shkronjës "A" më lart të rregullës 4, pas shkronjave të tjera bashkëtingëllore.

Numri i dytë 6 paraqet shkronjën "M" të mbiemrit të autorit. Shih rregullën 5 më lart për vlerën e shkronjës M.

Numri i tretë 6 paraqet shkronjën "O" të mbiemrit të autorit. Shih përsëri rregullën 5 më lart për vlerën e shkronjës "O".

Numri 2006 paraqet vitin e botimit të veprës.

Aplikimi i katerit në titull

Numri i katerit mund të aplikohet edhe në titull, kur mungon përcaktuesja kryesore, ose për shkak të praktikës për t'i mbajtur në radhë së bashku një koleksion të caktuar.

Për titullin "A Dictionary of Business" nga autori "John Pallister", të botuar nga "Oxford University Press" më 2003, mund të kemi një radhitje në bazë të titullit për dy arsye: E para për t'i mbajtur fjalorët të çfarëdo lloji (ang: dictionary) të radhitur afër njëri-tjetrit, dhe e dyta për t'i mbajtur fjalorët e botuar nga "Oxford University Press" të radhitur afër njëri-tjetrit që në njëfarë mënyrë janë të botuar edhe si një koleksion edhe pse ajo nuk paraqitet qartë në burim.

Shembulli. 2

65(038)

D538

2003

65(038) paraqet KUD-in, apo klasifikimin i cili i është caktuar fushës që mbulon fjalori

D538 paraqet katër shkronjat e para të titullit të veprës, d.m.th. <DICT> nga fjala e plotë <Dictionary>. Vëreni se shkronja e parë e titullit "A" nuk është marrë parasysh për shkak të kuptimit të ngushtë që ka në titull. Zakonisht merret fjala që

ka apo bart një kuptim semantik dhe e cila paraqet përmbajtjen e veprës në mënyrë sa më të kapshme.

"D" paraqet shkronjën e parë të fjalës "DICTIONARY" në titullin e dhënë

Numri i parë 5 paraqet shkronjën e dytë "I" të fjalës "DICTIONARY" në titullin e dhënë. Shih vlerën numerike të shkronjës "I" nën rregullën 4 në tabelën e katerit më lart.

Numri i dytë 3 paraqet shkronjën "C" të fjalës "DICTIONARY" të titullit të dhënë. Shih rregullën 5 më lart për vlerën e shkronjës "C". Pasi rregulla 5 thotë që vlera e shkronjës a-d (a deri d) është e barabartë me 3, atëherë shkronja "c" është ndërmjet "a dhe d" dhe si rezultat merr vlerën numerike 3.

Numri i tretë 8 paraqet shkronjën "T" të fjalës "DICTIONARY" në titullin e dhënë. Shih vlerën numerike të shkronjës "T" nën rregullën 5 më lart.

Numri 2003 paraqet vitin e botimit të veprës - fjalorit, respektivisht.

Gjatë radhitjes në raftë, duhet pasur kujdes pasi niveli i parë i radhitjes merret numri i klasifikimit (KUD) me të gjitha elementet e tij, i cili përcakton klasën se ku do të radhitet ajo vepër. Si i tillë është i radhitur në rreshtin e parë të tiketës, e cila ngjitet në shpinë të librit apo anash. Kriteri vjen si kategori apo kriter i dytë i radhitjes pas klasifikimit me KUD. Dhe, krejt në fund vjen kriteri i radhitjes së materialeve sipas vitit të botimit. Kjo do të thotë se nëse dy libra janë të së njëjtës klasë, ato së paku mund të dallohen nga njëra-tjetra sipas mbiemrit të autorit që merr vlera numerike të ndryshme, ose edhe nëse autori është i ngjashëm, atëherë dallimi së paku bëhet me vit të botimit.